



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr.60, datë 01.06.2020

“PËR

**DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 28, DATË 24.03.2020, TË KËSHILLIT
BASHKIAK “PËR KRIJIMIN E LEHTËSIRAVE FISKALE NDAJ BIZNESIT DHE
SHTYRJEN E AFATEVE TË APLIKIMIT PËR PROGRAMET SOCIALE TË
STREHIMIT NË KUADËR TË MASAVE PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES
SË INFEKSIONIT COVID-19”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 23, pika 6, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 113, të Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, vendimit nr. 243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 158 datë 26.12.2019 “Për miratimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”, Urdhrin 156, datë 10.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19”, Aktit Normativ Nr.3 datë 15.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid -19” dhe Aktit Normativ Nr.4 date 16.03.2020 “Për disa shtesa të Aktit Normativ Nr.3 datë 15.03.2020 të Këshillit të Ministrave “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid -19”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 28, datë 24.03.2020, të Këshillit Bashkiak “Për krijimin e lehtësirave fiskale ndaj biznesit dhe shtyrjen e afateve të aplikimit për programet sociale të strehimit në kuadër të masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit Covid-19”, bëhen këto shtesa si më poshtë:

1. Në pikën 2, pas shkronjës “a” shtohet shkronja “a/1, me këtë përmbajtje:
“a/1) Përfshirjen nga pagesa e tarifës së zënies së hapësirës publike për baret dhe restorantet për periudhën maj - qershor 2020”.
2. Pas pikës 2 shtohet pika 2/ 1 me përmbajtje si më poshtë:
“2/1. Uljen e detyrimit të lindur nga tarifa e pastrimit proporcionalisht për një periudhë 2 mujore për kategoritë sipas shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.”
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij vendimi.

4.Ky vendim hyn në fuqi sipas parashikimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015
“Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar.

K R Y E T A R

TONI GOGU